

VETËVENDOSJE!

KOPJIMI LEJOHET.
TË LUTEM, KOPJOJE!

GAZETË JAVORE | 20 KORRIK 2009 | nr. 202 | www.vetevendosje.org



Sovraniteti pa ekuivoke

Glauk Konjufca

Në kohën sa ishte nën sovranitetin e drejtpërdrejtë të Serbisë, Kosova kishte dy kufij ndërkombëtarë: kufirin me Shqipërinë dhe atë me Maqedoninë. Kurse, në anën tjetër, të gjithë e mbajmë mend që kur një banor i Kosovës udhëtonte për në Mal të Zi a Serbi, këtë gjë e bënte pa ndihmën e dokumenteve të udhëtimit, siç është, ta zëmë, pasaporta. Në termet e të drejtës ndërkombëtare, kjo do të thoshte që ishim nën sovranitetin e ish Republikës Federative të Jugosllavisë, më pas të Unionit Serbi-Mal i Zi. Pra kufijtë e Kosovës me të tjerët ishin, në fakt, kufij ndërkombëtarë të Serbisë me të tjerët.

Sot Kosova i ka tre kufij ndërkombëtarë me të cilët kufizohet – përveç Shqipërisë dhe Maqedonisë, në qershor të vitit 2006 është shtuar edhe Mali i Zi. Natyrisht, jo për fajin tonë, po për shkak se kështu vendosën 55% e malazezëve. Sot të nevojitet pasaporta që të kalosh prej Kosovës a Serbisë në Malin e Zi.

Te *Filozofia e së Drejtës*, G. W. F. Hegeli e jep një shpjegim shumë të

rëndësishëm të thelbit të sovranitetit. Ai e dallon sovranitetin e brendshëm (rendi institucional, siguria etj.) nga sovraniteti i jashtëm. Refleksioni i Hegelit për sovranitetin e brendshëm çon kah një përkufizim i funksionimit të entitetit shtetëror si njësi organike. Pra, shteti së brendshmi është *Njësi*. Dhe jo vetëm që e di që është njësi, por edhe vepron si e tillë. Kosova aktualisht nuk është *Njësi* (organike). Ajo është *Shumësi* (mekanike): Prania ndërkombëtare (ICO/EULEX-i, UNMIK-u, KFOR-i...), institucionet vendore (Qeveria, Parlamenti...), Serbia (strukturat paralele).

Por edhe më intrigues është koncepti hegelian për sovranitetin e jashtëm. Bile Hegeli mendon që sovraniteti i jashtëm vjen përpara të brendshmit. Ai thotë që, para së gjithash, "shteti është sovran në raport me të tjerët". Pra, një shtet është sovran në sytë e shteteve tjera dhe i pavarur nga ata. Sovraniteti i vërtetë i një vendi nuk matet, mbi të gjitha, me vetëkonceptin e tij të sovranitetit, thotë Hegeli, por me konceptin e të tjerëve për sovranitetin e tij. Pra, kjo është "jashtësia thelbësore". Këtë poentë hegeliane e njohin

shumë mirë sidomos ata që kanë jetuar gjatë kohës së politikës kosovare të viteve '90. Gjatë "epokës rugoviane" të politikës në Kosovë, sovraniteti matej gabimisht me vetëkonceptin e brendshëm të politikës sonë për Kosovën. Jetohej dhe banohej brenda këtij iluzioni të të qenit shtet, prandaj kjo gjë i konvenonte edhe Serbisë e cila nuk e prishte këtë iluzion, por edhe bashkësisë ndërkombëtare, të cilës i përshtatej ky "stabilitet" i ndërtuar mbi iluzione. Në të vërtetë, ne nuk ishim shtet për asnjë shtet tjetër (madje as për Shqipërinë!), përveçse për vetveten.

Sot problemi duhet të shtrohet kështu: sovraniteti i Kosovës duhet të matet si sovraniteti i Kosovës NDAJ Serbisë. Ndryshimi i statusit të Kosovës në skenën ndërkombëtare duhet të matet nëpërmjet të këtij kriteri substancial, sepse kufijtë tjerë ndërkombëtarë të Kosovës me vendet tjera (Shqipërinë, Maqedoninë, Malin e Zi) kanë mbetur po ata. I vetmi kufi të cilit duhet t'i ndryshojë statusi, në mënyrë që vetë Kosovës t'i ndryshojë statusi, është ai me Serbinë, e Kosova më së shumti vijë kufitare ndan me Serbinë. Sovraniteti ynë ndaj Serbisë është

(paradoksalisht vetëm në shikim të parë) shumë më i rëndësishëm sesa sovraniteti ynë ndaj 62 shteteve tjera sa e kanë njohur Kosovën deri tash. Për Irlandën është shumë më i rëndësishëm sovraniteti i saj ndaj Britanisë së Madhe, sesa ndaj të gjitha shteteve tjera së bashku që e njohin sovranitetin e saj.

Të gjitha strategjitë e deritashme ndërkombëtare dhe ato të politikës vendore e kanë reduktuar Kosovën në hapësirë josovrane të tregut të lirë ndaj vendeve tjera përreth (Kosova konsumatore), kurse ndaj Serbisë kanë ndjekur qasjen e hapjes së kufijve dhe rritjen e integritit me Kosovën (djegia e pikave doganore, trajtimi i kufirit si vijë administrative etj.). Tash Kosovës po i shkatërrohet çfarëdo mbështetje për sovranitet të brendshëm e të jashtëm nëpërmjet të shitjes së pasurive të saj natyrore prej të cilës Kosovës nuk do t'i mbetet asgjë tjetër përveçse një takse simbolike korporative. Nëse do ta lejojmë të ndodhë kjo gjë, politikisht dhe ekonomikisht do të kthehemi në qiraxhinj të leckosur. Nëse jo, atëherë duhet të përgatitemi për sfida që kërkojnë mobilizime të mëdha dhe sakrifica.

Tubim në Arbëresh

Javën që sapo e lamë pas, në Arbëresh (Vitimicë) të Pejës Lëvizja VETËVENDOSJE! organizoi një tubim publik me banorët e këtij lokaliteti. Të pranishëm ishin shumë qytetarë vendas, shqiptarë dhe boshnjakë.

Para pjesëmarrësve të këtij tubimi foli Albin Kurti i cili shpjegoi konceptin e VETËVENDOSJE!-s dhe zhvillimet politike në Kosovë. Meqë pavarësia nuk u arrit përmes së drejtës së vetëvendosjes së popullit tash duhet që pavarësisë post festum t'ia shtojmë sovranitetin i cili i mungon asaj, tha Albini. Në njërin anë nuk e kemi vetëvendosjen e brendshme (nuk i kontrollojmë resurset natyrore, s'kemi integritet territorial për shkak të strukturave të Serbisë dhe as fjalën e fundit në vend për shkak të Pieter Feithit e Yves de Kermabonit) kurse, në anën tjetër, nuk e kemi as aspektin e jashtëm të së drejtës për vetëvendosje (6 Pikëshi i Ban Ki-moonit po zbatohet në vendbanimet me shumicë serbe ndërkohë që vleni 1.3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës që nuk na e lejon bashkimin me Shqipërinë), theksoi Albini. Ai shpjegoi që në Kosovë nuk po vendos populli i Kosovës anipse ajo është bërë e pavarur – disa burokratë ndërkombëtarë bashkë me krerët politikë vendorë të korruptuar marrin vendime arbitrare në përputhje me interesa personale të tyre dhe të korporatave të huaja. Në Kosovë nuk pati referendum asnjëherë për asnjë gjë përfshirë këtu edhe çështjet kapitale si flamuri, himni, kushtetuta, decentralizimi e privatizimi, shtoi Albini. Këto dy të fundit janë projektet më të rrezikshme në të cilat e kanë futur Kosovën: i pari na e copëton territorin ndërkaq i dyti i shet pasuritë e Kosovës, potencoi Albini. Në fund, ai sugjeroi që organizimi dhe mobilizimi në bazë për çështjet politike dhe socio-ekonomike nuk ka zëvendësim, aq më tepër kur kemi këso elitash super të pasura në Kosovën e varfër si asnjëherë më parë.

Pas Albinit, të pranishmëve iu drejtua përgjegjësi i Qendrës së VETËVENDOSJE!-s në Pejë, Bajram Binaku, i cili foli për obstrukcionet e strukturave të Serbisë në komunën e Pejës, për stagnimin e ekonomisë vendore dhe papunësinë që e ka pllakosur Pejën, për kontestet kufitare me Malin e Zi që janë peshqesh nga Marrëveshja e Kumanovës, si dhe për zonën e veçantë të Patrikanës së Pejës që pengon lirinë e lëvizjes, turizmin, të drejtën e pronës përveçqë serbizon trashëgiminë kulturore ortodokse dhe uzurpon afër 300 hektarë tokë.

Në këtë tubim foli edhe përgjegjësi i Qendrës së VETËVENDOSJE!-s për Gjermani, Bashkim Osmanaj, i cili po ashtu është nga Peja. Ai u fokusua në gjendjen e diasporës shqiptare dhe iu bëri thirrje të gjithë atyre që jetojnë e punojnë në Gjermani ose kanë të afërt atje, të inkuadrohen në VETËVENDOSJE!.

Pasoi një debat i hapur me përplot zemërim për politikanët e Kosovës pa dallim partie e krahine dhe shumë prej banorëve të Arbëreshit, pjesëmarrës në tubim, shfaqën interesimin e tyre që të kontribuojnë në aktivitetet e Lëvizjes. Me këtë rast, detyrën e personit kontaktues të VETËVENDOSJE!-s për Arbëreshin (Vitimicën) e Pejës e mori i riu Dardan Lajçi.



Shoqëria civile e Pejës kundër Zonave të Veçanta

Të hënen, me 13 korrik 2009, në Pejë u mbajt një konferencë shtypi për gazetarë me rastin e nënshkrimit të peticionit të shoqërisë civile në Pejë kundër zonës së veçantë, kinse mbrojtëse, të Patrikanës së Pejës. 23 organizata, shoqata, lëvizje e degë të partive politike në Pejë e kanë nënshkruar këtë peticion, i cili do t'iu dërgohet institucioneve vendore dhe ndërkombëtare.

Para gazetarëve këtë peticion e prezentuan Bajram Binaku e Albin Kurti nga Lëvizja VETËVENDOSJE!, Veton Mujaj nga OJQ "Syri i Vizionit" dhe Rahman Jasharaj nga Shoqata e Vëllazërisë Kosovë - Malësi e Madhe. Në vijim është dhënë teksti i peticionit si dhe subjektet nënshkruese.

Peticioni

Ne, organizatat e shoqërisë civile, veprimtarë, përfaqësues subjektsh, personalitete e intelektualë të Pejës, me vetëdije dhe vullnet, deklarojmë që draftligji i "Zonave të Veçanta të Mbrojtura" në Kosovë nuk është në shërbim të ruajtjes së monumenteve tona historike për ne dhe gjeneratat e reja, por është në shërbim të politikave të Serbisë për uzurpimin e trashëgimisë sonë kulturore, si dhe për ta bërë vendin tonë jofunksional. Ky ligj do të legjitimojë pretendimin e Serbisë që të gjitha monumentet dhe kishat ortodokse në Kosovë t'i përvetësojë për trashëgimi të saj, duke mohuar kështu kulturën e përbashkët fetare dhe historike të Kosovës, e cila është karakteristikë dhe për qytetin tonë. Gjithashtu, ky ligj e lejon Kishën Ortodokse Serbe me seli në Beograd, të ushtrojë të drejtën e vetos karshi cilitdo vendim të përfaqësuesve komunalë, i cili do ta prekte papranueshëm për qytetaret e Pejës, gëzimin e të drejtës për lëvizje të lirë.

Pra, përmes këtij peticioni, ne e kundërshtojmë projektin e "Zonave të Veçanta të Mbrojtura", i cili e rrezikon seriozisht qytetin tonë, të ardhmen tonë dhe atë të fëmijëve tanë.

Subjektet nënshkruese

Nr	Subjekti	Emri dhe mbiemri	Numri personal
1	Lëvizja VETËVENDOSJE! - Pejë	Bajram Binaku	1013434413
2	OJQ "Ekzistenca"	Muhamet Nikqi	1003781549
3	OJQ "ASDR"	Dritan Shala	1009003114
4	OJQ "Uji Për Mileniumin e III-të"	Halit Gashi	1003237374
5	OJQ "Syri i Vizionit"	Veton Mujaj	1001422207
6	OJQ "Udruzenje Bošnjaka OAZA"	Sahit Kandić	1018190172
7	OJQ "Sh. V. Kosovë - Malesi e Madhe"	Ukshin Jashari	1008706324
8	OJQ "Arnika"	Zenel Shala	1009707774
9	OJQ "Euroekologët"		
10	Deputeti i Kuvendit të Kosovës	Numan Balić	1009688435
11	OJQ. SH. F. B "AGRO-LEO"	Dukagjin Deda	1003299593
12	OVL e UÇK-së - Pejë	Pren Marashi	1018903209
13	SH. F. D e UÇK-së - Pejë	Safete Shalaj	1003718774
14	IRDK - Pejë	Xhevdet Neziraj	10003183803
15	Nëndega e IV e AAK-së "Haxhi Zeka"	Hydverdi Spahija	10002765302
16	Avokati	Naser Hasaj	1003669781
17	Dega e PDK-së - Pejë	Rexhë Abazi	1003716275
18	S. B. A. SH - Pejë	Justuf Kelmendi	1009704476
19	Nëndega e AAK-së - Tërstenik	Florim Shala	1002916297
20	Anëtari i Kryesisë së LDD-së - Pejë	Dr. Ibrahim Rexhaj	1003666162
21	Kryetari i aktivitetit të LDK-së - Jabllanicë e Vogël	Musa Rexhaj	1006839386
22	Kryetari i LDK-së - Radac	Gani Kurtaj	1009181306
23	Stranka Demokratske Akcije (SDA)		

55 tezat (II)

1.5 Apartheidi dhe sociocidi

Gjatë kohës së Milosheviqit Serbia në Kosovë ka ushtruar apartheid dhe kryer sociocid. Ajo e ka shkatërruar themelin social të shqiptarëve të Kosovës, duke na hequr nga puna në mënyrë të dhunshme, pra duke na e hequr mbështetjen e ekzistencës; duke na e ndaluar shkollimin, pra duke na e këputur mundësinë e përparimit; duke na i uzurpuar pasuritë natyrore, pra duke na e ndërprerë zhvillimin me forcë; duke na e mohuar lirinë politike dhe identitetin, pra duke u përjekur të na e shlyejë qenien tonë.

Strategjia e partisë më të madhe politike shqiptare gjatë kësaj kohe në Kosovë nuk ka qenë luftimi i pushtimit, por përshtatja me të. Mendohej që liria vinte kryesisht duke e prituri atë. Kjo politikë e gabuar për tetë vite me radhë ka kultivuar zyrtarisht një shpirt kolektiv konformist dhe apatik, pasojat e të cilit ndjehen edhe sot e kësaj dite.

Serbia nuk kishte problem me këtë strategji sepse i konvenonte ajo: shqiptarët ishin jashtë sistemit zyrtar dhe nuk po kryengriteshin. Kjo politikë e gabuar e nënshtrimit ia mundësonte Serbisë shfaqësimin përpara bashkësisë ndërkombëtare.

Teza 15. Serbia e do Kosovën veç serbe. Serbia i do shqiptarët veç si pakicë. Duke marrë parasysh përbërjen e popullsisë së Kosovës, Serbia e do Kosovën në mënyrë a priori kriminale: dëshira e saj realizohet ose me dëbimin, ose me vrasjen e shumicës së shqiptarëve.

1.6 Lufta çlirimtare dhe tjetërsimi i saj

Formimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe nisja e luftës sonë çlirimtare paraqet periudhën më të rëndësishme historike në të cilën u sublimua ushtarakisht krejt përpjekja dhe sakrificat e brezave të kaluar. Shumë bazat logjistike dhe depo armatimi të UÇK-së ishin brenda Shqipërisë. Përveç kësaj, UÇK-së iu bashkuan edhe komandantë të shquar nga Shqipëria, si dhe të rinj nga Maqedonia e Lugina e Preshevës.

Teza 16. Lufta jonë çlirimtare kishte karakter kombëtar. Kombi reagoi si një trup, me gjithë vështirësitë dhe

pengesat e vëna nga politika zyrtare.

Në një çast të caktuar, lufta çlirimtare u tjetërsua nën ndikimin e faktorëve ndërkombëtarë. Udhëheqja politike e UÇK-së u shndërrua në servis teknik të këtyre faktorëve. Çlirimi i atdhit si qëllim u zëvendësua me atë të ndërhyrjes së NATO-s. Pas kësaj ishte tjetërkush ai që diktonte fatin tonë kolektiv. Nuk kishte më planifikim politik për ta projektuar interesin e Kosovës në raport me synimet e bashkësisë ndërkombëtare. Por përshtatje tërësore me projektin e bashkësisë ndërkombëtare për ne, dorëzim në bashkësinë ndërkombëtare. Shteti serb në luftën e fundit në Kosovë vrau mbi 12.000 njerëz. Mbi 95 % prej tyre civilë të pafajshëm. Të pambrojtur. Kryesisht fëmijë, gra dhe burra të moshuar. Më shumë se 1.000 persona të rrëmbyer janë ende të pagjetur. Pjesa dërmuese e tyre gjenden në Serbi. Afër 20.000 femra të dhunuara. 740.000 persona të deportuar dhunshëm. 120.000 shtëpi të shkatërruara nga ushtria serbe. Ekonomia e rrënuar.

2. Kosova ndërkombëtare

2.1 Marrëveshja e Rambujesë

Gjatë muajve tetor 1998-janar 1999, i dërguari amerikan për Kosovën dhe ambasadori i ShBA-ve në Maqedoni, Christopher Hill, me ndihmën e ekspertëve të tij legalë, ndërhyri mes luftës sonë çlirimtare dhe fushatës gjenocidale të Milosheviqit për arritjen e një marrëveshjeje për paqe. Për katër muaj ai sollti katër draftetë të marrëveshjes. Këto draftetë parashihnin një autonomi tejet të kufizuar të Kosovës në Serbi, fakt ky që e pranonin pothuajse shumica e krerëve politikë shqiptarë të asaj kohe. Të gjitha këto draftetë u refuzuan nga udhëheqja e UÇK-së. Më 29 janar të vitit 1999 Grupi i Kontaktit i mbledhur në Londër doli me kërkesën e mbajtjes së një konference ndërkombëtare për Kosovën, ku do të zhvilloheshin negociatat mes përfaqësuesve të Serbisë dhe atyre të Kosovës për përfundimin e luftës. Grupi i Kontaktit vendosi parimet e panegociueshme jashtë të cilave nuk mund të dilte korniza e marrëveshjes së ardhshme për Kosovën. Njëri prej këtyre parimeve, për të cilin as që mund të diskutohet, ishte që zgjidhja të gjendej domosdoshmërisht përbrenda autonomisë së Kosovës në Serbi.

Teza 17. Meqë delegacioni i UÇK-së

udhëtoi në Rambuje, ai pranoi këtë parim.

Përveç kësaj, Marrëveshja e Rambujesë ishte një sintetizim i draftetë të Hillit, kurse draftetë e Hillit ishin refuzuar nga UÇK-ja. Pas negociatave disaditore në kështjellën e Rambujesë mes delegacionit shqiptar dhe atij serb, ekspertët juridikë të Grupit të Kontaktit erdhën deri te forma përfundimtare e marrëveshjes. Marrëveshja e Rambujesë u nënshkrua më 18 mars 1999 në Paris nga Hashim Thaçi, Ibrahim Rugova, Veton Surroi dhe Rexhep Qosja.

Marrëveshja e Rambujesë, në parathënien e saj artikulon qartë zotimin e bashkësisë ndërkombëtare për ruajtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial të ish Jugosllavisë: "Duke rikujtuar zotimin e bashkësisë ndërkombëtare për sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës Federale të Jugosllavisë." Në Pikë 3 të Nenit 1 të Kapitullit 1 të Rambujesë, thuhet: Republika Federale e Jugosllavisë mban përgjegjësi në Kosovë për fushat vijuese, përveç nëse është përcaktuar në vend tjetër në këtë marrëveshje: (a) integriteti territorial, (b) ruajtja e tregut unik brenda Republikës Federale të Jugosllavisë, pushteti së cilës do të ushtrohet në mënyrë të tillë që të mos bëjë diskriminimin ndaj Kosovës, (c) politika monetare (ç) mbrojtja, (d) politika e jashtme, (dh) shërbime doganore, (e) tatimet federale, (ë) zgjidhjet federale, dhe (f) fushat tjera të përcaktuara me këtë Marrëveshje." Në Marrëveshjen e Rambujesë Serbia nuk definohej si agresore dhe okupatore, kurse UÇK-ja trajtohet sikur grupet paramilitare serbe. Sipas marrëveshjes, në Kosovë do të duhej të mbeteshin 2.500 ushtarë dhe 1.500 policë të ish Jugosllavisë.

Rambujeja parashihte që shqiptarët të përfaqësoheshin në Kuvendin e Serbisë dhe në Dhomën e Qytetarëve të RFJ-së, por jo në Dhomën e Republikave të RFJ-së. Prandaj kjo zgjidhje ishte më pak se Kushtetuta e vitit 1974. Shqiptarët nuk njiheshin si popull, por vetëm si "bashkësi nacionale".

Teza 18. Duke mos na definuar si popull, por si "bashkësi nacionale", popullit të Kosovës iu mohua e drejta e ushtrimit të së drejtës për vetëvendosje sepse kjo e drejtë u takon popujve e jo "bashkësive nacionale".

Serbia nuk e nënshkroi Marrëveshjen e Rambujesë. Sa për pjesën politike, Serbia do ta kishte nënshkruar marrëveshjen. Kjo është thënë nga shumë zyrtarë serbë dhe negociatorë ndërkombëtarë. Arsyeja pse Serbia nuk e nënshkroi marrëveshjen e Rambujesë ishte aneksi ushtarak: sipas këtyre dispozitave, ushtrisë dhe trupave të NATO-s i lejohej qarkullimi dhe qasja në tërë territorin e ish RFJ-

së, duke përfshirë këtu edhe shfrytëzimin e ujërave (atë kohë pjesë e ish RFJ-së ishte edhe Mali i Zi).

Teza 19. Ndërhyrjen e NATO-s nuk e ka legjitimuar nënshkrimi shqiptar, por mosnënshkrimi serb.

Teza 20. Delegacioni shqiptar e ka pranuar marrëveshjen pa e ditur që atë nuk do ta pranonin serbët. Delegacionin shqiptar nuk e shfaqëson asgjë.

2.2 Marrëveshja Ahtisaari-Chernomyrdin

Aty kah fillimi i majit të vitit 1999, meqë fushata e NATO-s po zgjaste aq sa rrallëkush do ta kishte menduar, në qarqet e ndryshme të bashkësisë ndërkombëtare filloi të vërehej një gatishmëri më e theksuar për arritjen e kompromisit me Milosheviqin. Më 6 maj në Shën Petersburg të Rusisë u mbledhën Ministrat e Jashtëm të G-8. Për herë të parë u përvijuan konturat e dy kompromiseve që bashkësia ndërkombëtare ishte e gatshme t'ia bënte Milosheviqit. Deklarata e G-8 (S/1999/516) njihet si Aneksi I i Rezolutës 1244.

Dokumenti i kompromisit iu paraqit parlamentit të ish RFJ-së nga Marti Ahtisaari, atëherë përfaqësues i Bashkimit Evropian dhe nga Viktor Chernomyrdin, kryeministër i atëherëshëm i Rusisë (përfaqësues amerikan në treshen diplomatike ishte Strobe Talbot, nënsekretar i shtetit).

Dokumenti Ahtisaari-Chernomyrdin (S/1999/649) njihet si Aneksi II i Rezolutës 1244.

I pari kompromis kishte të bënte me misionin e ardhshëm ndërkombëtar; i dyti me raportin e NATO-s me ish RFJ-në. Sipas kompromisit të parë, trupat e NATO-s kishin të drejtë të qarkullojnë vetëm përbrenda territorit të Kosovës. Kurse sipas Marrëveshjes së Rambujesë, trupat e NATO-s kishin të drejtë të kishin qasje në krejt territorin e ish RFJ-së. Kjo ishte pika e parë e kompromisit.

Pika e dytë e kompromisit ishte që misioni ndërkombëtar në Kosovë të jetë prej OKB-së, sepse kështu këmbënguli Milosheviqi. Pasi u arrit ky kompromis, Serbia e pranoi Marrëveshjen e Rambujesë. Ajo u aprovua në parlamentin e ish RFJ-së, më 3 qershor të vitit 1999.

Teza 21. Kjo e rikonfirmoi përfundimin se Serbia kishte problem kryesisht me aneksin ushtarak të marrëveshjes.

(vazhdon në numrin e ardhshëm)

Kundërshtarët e bashkimit kombëtar

Basri Kodra

Ndonëse aty këtu akoma shkruhet dhe flitet shpesh për temën e madhe të quajtur *bashkimi kombëtar*, duket se gjithnjë e më shumë po i largohemi asaj. Arsyet që më bëjnë të mendoj se po i largohemi çështjes së bashkimit kombëtar, jo vetëm si ide, por si realitet, janë të shumta. Njëra ndër to është edhe kjo: përderisa gjatë gjithë kohës së mëparshme e deri në kohën e luftës së fundit, duke e përfshirë edhe këtë kohën e luftës, çdo lëvizje popullore dhe kombëtare, në çfarëdo forme të organizimit të saj që mund të ketë qenë, kishte si synim kryesor çështjen e bashkimit kombëtar të shqiptarëve, tani ndodh pikërisht e kundërta: asnjë parti politike parlamentare nuk e ka më këtë synim dhe as që merret më me këtë punë! Kur them, se po i largohemi gjithnjë e më shumë, kjo nuk do të thotë në asnjë mënyrë, se unë gjithnjë e më pak kam shpresë se ai bashkim do të ndodh. Kurrresi. Madje sa më shumë kundërshtarë që mund të vërej se shfaqen, aq më shumë bindem se ai bashkim do të ndodhë një ditë. Do të ndodhë për shkak se është e natyrshme të ndodhë. Do të ndodhë sepse e kundërta e tij është e panatyrshme. Do të ndodhë, në fund të fundit, ashtu siç thoshte Faik Konica, se "Shqipëria do të bëhet për inat të shqiptarëve", prandaj, Kosova dhe jo vetëm ajo, do të bashkohet me Shqipërinë për inat të këtyre shqiptarëve!

Sa shumë kundërshtarë të bashkimit kombëtar ka sot në hapësirën shqiptare! Është vërtet e habitshme. Kundërshtarë të jashtëm të bashkimit të shqiptarëve ka pasur gjithmonë – prej se lindi vetë nevoja e bashkimit. Ndërsa, kundërshtarë të brendshëm, kurrë nuk ka pasur në formën dhe në stilin e paraqitjes së të tanishmëve.

Këtu le të merremi vetëm me këta të brendshmit, pra kundërshtarët shqiptarë të bashkimit kombëtar shqiptar.

Kush janë kundërshtarët e bashkimit të shqiptarëve brenda shqiptarëve? A mund t'i identifikojmë ata? Dhe, me tej, a mund t'i hetojmë shkaqet që i shtojnë ata të jenë kështu - kundërshtarë të vetvetes? Qëllimi i ngritjes së këtyre pyetjeve është që të mund të japim përgjigje në pyetjen tjetër të patjetërsueshme: cilat janë pasojat e një sjelljeje të tillë vetëkundërshtuese për shqiptarët?



S'ka dyshim se kundërshtarët më të mëdhenj, që mund të radhiten në rendin e parë, janë politikanët tanë. Politikanët shqiptarë, pavarësisht se në cilin shtet aktualisht veprojnë ata zyrtarisht, janë sot kundërshtarët më të mëdhenj të bashkimit kombëtarë të shqiptarëve, dhe si të tillë, ngase qëndrojnë edhe në pikat më të larta të pushtetit, janë me efekte shumë dëmtoese për jetën shoqërore, politike, kulturore dhe kombëtare të popullit shqiptar. Të gjitha grupet e tjera të kundërshtarëve, janë pasojë e veprimeve të këtyre politikanëve në fjalë. S'do mend se, ata (politikanët tanë) i nxitë dikush nga jashtë që të veprojnë kështu, por kjo neve as që duhet të na

interesojë, dhe as të na shkojë në mendje t'i fajësojmë ata pse po i nxisin këta, e t'i çfajësojmë këta pse u dashka t'i dëgjojnë patjetër ata. Kurrresi. Them kështu, ngase, jo rrallë herë kam dëgjuar përpjekje të njerëzve të rëndomtë për të çfajësuar politikanë të caktuar për ndonjë sjellje plotësisht të papëlqyeshme prej popullit, me shprehje si "po, edhe ai s'ka pasuë dëshirë të bëjë këtë, por ja që s'ka pasë nga t'ia mbajë, ngase e kanë shtrënguar këta ndërkombëtarët", e të tjera të ngjashme!

Në rendin e dytë të kundërshtarëve

kundërshtues. Jeta e të dytit varet shumë prej të parit, sikundër jeta e të parit që varet shumë prej veprës së të dytit. Pra është, thjesht, interes i ngushtë i gërshetuar.

Dhe, në rendin e tretë të kundërshtarëve të mëdhenj, e që vijnë pas politikanëve, gazetarëve dhe analistëve, janë organizatat e ndryshme të shoqërisë civile. Kuptohet që jo të gjitha organizatat e këtij lloji. Të gjitha ato që u thanë për grupin e dytë mund të thuhet edhe për këtë grupin e tretë.

Motivet që i shtojnë këta kundërshtarë të veprojnë kështu kundër kombit shqiptar, janë fare të ngushta, të ulëta dhe si të tilla tejet primitive.

Ndërsa pasojat e një sjelljeje të tillë janë mjaftë dëmtoese. Ndikimi i këtyre grupeve është i madh, është i shumanshëm dhe me pasoja larghedhëse. Ndikimi i tyre më i drejtpërdrejtë dhe i përtashëm negativ është krijimi i një opinioni kundërshtues ndaj çështjes së përbashkët kombëtare dhe domosdoshmërisë së bashkimit tonë. Lehtë mund të vërehet ky disponim në popull, dhe kjo politikanëve iu konvenon, sepse ata kanë nevojë për një disponim të tillë.

Kur mendon njeriu këto gjëra, i shfaqet një, si të thuash, instinkt, i cili të thërret të madhe: ndaluni o njerëz, ndaluni dhe shiheni veten se ç'jeni duke bërë, mos veproni kështu kundër vetvetes! E vërteta, e drejta, e ndershme, njerëzoria, madje edhe historia, janë kundër jush. Sepse ju jeni kundër të gjithave, dhe si të tillë, patjetër edhe kundër vetvetes.

Si pasojë e sjelljes së këtyre kundërshtarëve kryesorë të bashkimit kombëtar, janë shfaqur, pra, edhe kundërshtarët dytësor, e të cilët, po ashtu mund të klasifikohen në grupe të ndryshme. Për këtë kategori të kundërshtarëve, shpresoj të shkruaj herën tjetër.

Lëvizja VETËVENDOSJE! është komunitet i njerëzve që refuzojnë të nënshtrohen. Ajo synon arritjen dhe realizimin e vetëvendosjes për popullin e Kosovës. Lëvizja VETËVENDOSJE! angazhohet edhe për ndryshime radikale shoqërore e politike që do të mundësonin respektimin e të drejtave të njeriut, të drejtave civile dhe drejtësisë sociale për të gjithë dhe secilin në Kosovë pa kurrfarë diskriminimi.

VETËVENDOSJE!

**KOPJIMI LEJOHET.
TË LUTEM, KOPJOJE!**

Rr. "Perandori Justinian" nr. 9
Qyteza Pejton
Prishtinë, Kosovë
038 222 704
+37744509858
vetevendosje@hotmail.com
vetevendosje@yahoo.com
vetevendosje@gmail.com
www.vetevendosje.org